

FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS
QENDRORE TË TURQISË

Sureyya Serdengeci
Gubernur i Bankës Qendrore të Turqisë

Do të doja të falenderoja organizatorët e kësaj konference, si dhe në veçanti Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, z. Cani, që më dha mundësinë të vizitoj Shqipërinë, me të cilën Turqia ka marrëdhënie historike të hershme. Po të shohim rolin që luan banka qendrore në konvergjencën e ekonomisë kombëtare në integrimin ekonomik drejt Europës, ne do të vëmë re se si kriteret e Maastricht janë përdorur si një pikë referuese- nuk është fjala vetëm për inflacionin e ulët por, gjithashtu, për pavarësinë institucionale, personale, financiare të bankës duke përfshirë dhe kreditimin e qeverisë jo nga banka qendrore. Niveli i PBN-së është, gjithashtu, i rëndësishëm, sepse kjo ka një ndikim të rëndësishëm për një politikë monetare efektive. Së paku, eksperiencia turke ka plot evidenca që dëshmojnë për këtë.

Nga ana tjetër, zhvillimi i një sistemi financiar të shëndoshë, i bazuar përsëri në eksperiencën turke, duket, gjithashtu, të jetë i pashmangshëm në procesin e konvergencës. Në qoftë se do t'i referoheshim regjimit të kurseve të këmbimit, shohim se disa vende kanë regjimin bord monedhë, disa të tjera nga ana tjetër, kanë regjim plotësisht luhatës të kurseve të tyre si dhe akoma disa të tjera, kanë sistem luhatës të drejtuar. Duket të jetë dhe një model tjetër i vetëm në rrugën drejt bashkimit monetar.

Ne jemi të vetëdijshëm që të gjitha këto modele mund të jenë të suksesshme në qoftë se ndiqen politika ekonomike të frytshme. Një ekonomi kombëtare mund të përdorë regjimin e kurseve të drejtuar, për të ulur inflacionin dhe më pas e luhat monedhën e saj për pak kohë para se të hyjë në bashkimin monetar. Në qoftë se nuk është e suksesshme në këtë mënyrë të të vepruarit, ndoshta është i nevojshëm një angazhim monetar më i fortë, për të shkuar drejt një bord monedhe të plotë, duke kaluar nëpërmjet një bord monedhe të pjeshme, sikurse është dhe rasti i Turqisë. Në rast se të gjitha këto modele janë të gabuara (dështojnë), për një arsye ose një tjetër, një përshtatje e njëanshme e euros, është një çështje që akoma po diskutohet. Gjithësesi, konvergimi i monedhës, pa qenë në gjendje që të konvergosh ekonominë e vendit, nuk është pa rreziqe, duke patur parasysh problemet që shtrohen, në ato raste, kur lind nevoja që Banka Qendrore Europiane të luajë rolin e huadhënësit të fundit, në veçanti kur në ekonominë e vendit nuk ekziston një sistem financiar i shëndetshëm.

Tani dua të përqendrohem në rastin e Turqisë. Turqia, sikurse e dini, është një vend me inflacion kronik për rreth 25 vjet, ku inflacioni asnjëherë nuk u kthye në hiperinflacion, duke iu dhënë turqve, në përgjithësi, përshtypjen e gabuar që vendi i tyre është rast i veçantë, pothuajse ka fituar imunitet nga ligjësitë ekonomike. Kjo nuk ishte e vërtetë. Ajo çfarë përcaktonte inflacionin kronik në Turqi, ishte kryesisht deficit i sektorit publik në të kaluarën ndërsa në vitet '90, më tepër ishin pritjet inflacioniste të bazuara në inflacionin e kaluar si dhe kurset e këmbimit.

Kështu që në vitin 1999, më së fundi qeveria vendosi të stabilizojë ekonominë dhe spiranca e programit u zgjodh në mënyrë të dukshme - kurset e këmbimit. Banka qendrore duhet të kishte reaguar si një regjim pjesërisht bord monedhe, sikurse ne e quajmë tani atë, duke nënkuptuar që krediti i brendshëm do të

ishite konstant dhe kursi i këmbimit do të ndiqte një rrugë të paracaktuar zhvlerësimi, përkrah objektivit të inflacionit.

Përfitimet që solli programi, për njëfarë kohe, ishin rënia e normave të interesit, rënia e inflacionit, por dolën në pah edhe probleme të tjera. Gabimet në reformat e sistemit bankar, rritja e përgjysmuar goditën qeverinë, duke treguar domosdoshmërinë e reformave të tjera strukturore. Më tej, gjendja e pafavorshme e llogarisë korentë çoi në një sulm dyfazësh ndaj monedhës vendase. Mirëbesimi në angazhimet e bankës qendrore për kursin e këmbimit ishte plotësisht i humbur përveç se objektivi numerik për politikën monetare dhe fiskale ishte arritur në çdo kohë. Së fundi, në shkurtin e këtij viti, banka qendrore dhe qeveria vendosën që të luhasnin monedhën.

Luhatja e monedhës, për këtë arsye erdhi në një moment të papritur për sistemin bankar dhe për publikun, në përgjithësi. Në vend që të shkonte drejt luhatjes së monedhës në fund të programit trevjeçar, përgjatë pjesës së dytë të të cilit do të kishte një interval kohor për rreth rrugës së kursit të këmbimit, vendi u zgjua një ditë dhe gjeti monedhën e tij të luhatshme. Papritur nuk kishte më spirancë në ekonomi. Sistemi bankar dhe sektori i korporatave kishin pozicione të hapura në monedhë të huaj në një shkallë të madhe. Për këtë arsye, filloi një proces i dhimbshëm, për të cilin banka qendrore dhe thesari ndërmorën një sërë operacionesh për të përshtatur sistemin bankar me mjedisin e ri ekonomik të krijuar. Autoritetet e mbikëqyrjes së pavarur, të cilat ishin relativisht të reja në vend, morën përsipër shumë presion dhe vepruan me shumë rregullime për të rehabilituar sistemin bankar, i cili ka qenë i neglizhuar për më shumë se një dekadë. Fakti që nuk kishte më spirancë, ishte një nga problemet më të rëndësishme: kursi i këmbimit ishte përdorur dhe nuk kishte më mirëbesim në të. Një harmoni ndërmjet agregatëve monetarë dhe inflacionit nuk mund të vendosej në një mjedis me një inflacion kronik, sikur ishte e vështirë me nxitjen e kërkesës për para. Kjo ishte diagnoza shumë kohë më përpara. Kështu, përveç inflacionit të lartë, ne ngelëm vetëm me një mundësi - për të lëvizur drejt regjimit të *inflation targeting* (objektivi kryesor inflacioni) sa më shpejt që të ishte e mundur për të vepruar në këtë mënyrë.

Ku jemi ne tani? Po të shohim se çfarë kemi bërë në këta tetë muajt e fundit ose pak a shumë në këtë kohë, gjëja e parë që ne duhet të përmendim është se mbas 25 vjet të një inflacioni kronik, më së fundi banka qendrore është e pavarur. Amendamente të ligjit iu paraqitën Parlamentit në maj dhe ato u bënë efektive. Të

gjitha kriteret e Maastricht-it, që lidhen me bankën qendrore dhe me politikën monetare ndodhen brenda në ligj tani.

Deri tani ne kemi bërë një punë domethënëse në bankën qendrore, në fusha të ndryshme. Një nga këto fusha ishte zhvillimi i modelit të parashikimit të inflacionit që, sigurisht, do të na nevojitet për të ardhmen kur ne të ndjekim *inflation targeting*, dhe në këtë drejtim unë mendoj se kemi bërë goxha rrugë. Një fushë tjetër, në të cilën ne kemi punuar në bankën qendrore ishte zgjerimi i bazës së informacionit. Kështu, përveç vëzhgimeve të shumta që kemi ndërmarrë me sektorin e korporatave në mënyrë që të njohim më shumë rreth të ardhmes së ekonomisë, tani kemi vëzhgime të reja që ne i ndërmarrim me sektorin financiar, të cilat janë më të shpeshta dhe ato na japin më shumë informacion rreth nivelit të përgjithshëm të pritjeve në ekonomi.

Një fushë tjetër, në të cilën ne kemi punuar, dhe kjo duket të jetë me të vërtetë e vështirë, është zhvillimi i një strategjie të duhur dhe të frytshme në mënyrë që banka qendrore të jetë në gjendje të shpjegojë tashmë politikën e saj monetare transparente dhe veprimet e saj në publik. Dhe kjo është një nga fushat më të vështira, kështu që ne jemi akoma duke punuar për të.

Por ne, gjithashtu, duhet të shohim disa zhvillime në fusha të tjera. Këto janë fusha që nuk janë plotësisht të dukshme nën kontrollin e bankës qendrore. Një nga fushat është, që ne duhet të shohim një dobësim të efektit post-traumatik nga kursi i këmbimit drejt inflacionit në kohë, në qoftë se duam të ndjekim tamam *inflation targeting*. Efektet post-traumatike kanë qenë shumë të forta historikisht dhe duken të jenë akoma. Një fushë tjetër, e cila është shumë e rëndësishme dhe në fakt qëndron mbrapa problemeve tona në këtë dekadën e fundit, është problemi i dominancës fiskale. Fakti që Thesari Turk ka dominuar tregun e borxhit të brendshëm, për pothuajse një dekadë, duket të jetë një problem i madh nëse ne mendojmë të ndjekim regjimin e *inflation targeting*, në të ardhmen e afërt. Ne po paraqesim të gjitha llojet e përpjekjeve për të dobësuar pozicionin e thesarit në tregun e borxhit të brendshëm, kështu që dhe banka qendrore është më e lirë të ndryshojë normën e saj afatshkurtër të interesit, dhe mund të ndërmarrë një politikë të mirëfilltë monetare.

Një problem tjetër me të cilin ne po përballemi, brenda këtyre tetë muajve të fundit, është sigurimi i njëfarë stabiliteti në kursin e këmbimit nën regjimin luhatës të kurseve të këmbimit, për shkak se regjimi luhatës erdhi në një kohë me të vërtetë të papritur, ku

sistemi bankar dhe publiku u gjendën papritur me pozicione të hapura të mëdha, sikurse dhe e përmenda, ne duhet të ndërmarrim një sërë operacionesh. Këto operacione duken tani të kenë përfunduar dhe në dy muajt e fundit, pak a shumë, ne pamë që kursi i këmbimit u bë pothuajse i qëndrueshëm, përveç faktit që ndërhyrja e bankës qendrore është pothuajse joekzistente.

Kështu, nën programin aktual, ne jemi duke planifikuar të vazhdojmë më tej me regjimin e *inflation targeting*, përveç vazhdimit të ekzistencës së inflacionit të lartë edhe për pak kohë në vitin e ardhshëm. Sikurse ne e dimë kjo është e vetmja rrugë. Jashtë nga inflacioni kronik i Turqisë, ne duhet të punojmë akoma më shumë në këtë drejtim.

Ky ishte materiali që kisha përgatitur për prezantimin tim të shkurtër. Faleminderit për vëmendjen tuaj.